Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Ilir Halili	**03.01.2024**	**12.01.2024**	**2023/1064**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 29.12.2023, OE "ARITECH"- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/1064, kundër njoftimit për kontratë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "ARITECH"- Prishtinë, apo kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Marreveshje kornize – Furnizim me Pajisje te Teknologjise Informative per USHAF" me nr. të prokurimit: "98400-23-13505-5-5-8", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – UNIVERSITETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA NË FERIZAJ.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedur? t? hapur, negocuar, kufizuar, lloji i kontrat?s: pun?, furnizim, sh?rbim, vlera e parashikuar e kontrat?s: xx,xxx €.Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/1064 i dt:29.12.2023.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

AK ka shkelur gjatë realizimit të kësaj procedure ka shkelur dispozitat e LPP-së si më

poshtë:

Neni 10

Mjetet për promovimin e Transparencës

1. Me kërkesën me shkrim nga cilado palë e interesit, autoriteti kontraktues i siguron qasje të

arsyeshme palës që kërkon të ketë qasje në të dhënat e përshkruara në paragrafin 1 dhe 2 të

këtij neni, përveç informatave sekrete afariste të cilat vërtetohen si të tilla nga një autoritet

përkatës që kanë të bëjnë me çfarëdo aktiviteti të prokurimit që është mbyllur. Për qëllime të

paragrafit 3. të këtij neni, aktiviteti i prokurimit konsiderohet i mbyllur (i) në datën e publikimit të

4/8

njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit, (ii) në

datën e dhënies së kontratës në rast të tenderëve sipas nenit 37 të këtij ligji, ose (iii) nëse

aktiviteti i prokurimit formalisht është anuluar ose përndryshe është përfunduar para dhënies

ose zgjedhjes së fituesit, atëherë në datën e njoftimit për anulim sipas paragrafit 2. të nenit 62

të këtij ligji ose në datën kur aktivitetet ishin përmbyllur.

2. Autoriteti kontraktues do të sigurojë qasjen e kërkuar nga paragrafit 3. i këtij neni në mënyrë

të rregullt, të qetë, dhe pa pengesa. Sidoqoftë, autoriteti kontraktues mundet që të mbikëqyrë

qasjen në fjalë ose të marrë masa të arsyeshme për të ruajtur integritetin e të dhënave.

3. Autoriteti kontraktues, me kërkesë të një pale të interesuar, do të bëjë dhe do t'i sigurojë palës

së tillë të interesuar një kopje të çfarëdo materiali në të cilin pala e tillë e interesuar ka të drejtë

qasjeje sipas paragrafit 3 të këtij neni.

Neni 59

Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

1. Autoriteti kontraktues do të themeloi një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe

krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë

individuale për vlerësimin e kryer të ofertës. Me fillimin e zbatimit të prokurimit elektronik, KRPP□ja do ta nxjerrë legjislacion dytësor lidhur me këtë çështje

Ne me date 14.12.2023 kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Ne njoftimin mbi vendimin AK ka vendosur te shperbleje me kontrate OE TECH VISION SH.P.K.

Ne kemi kerkuar qasje ne dokumentet e dorezuara per dy OE pjesemarres me te lire sipas çmimit te ofruar.

Autoriteti Kontraktues na ka mundesi qasje ne dokumentet e dorezuara, por jo ne te gjitha dokumentet te dorezuara, pra ne kundershtim me LPP na ka ofruar qasje te pjeseshme.

Autoriteti juaj na ka dorezuar ne menyre fizike dokumentet ne vijim te OE Tech Vision dhe Cacttus:

Pershkrimi i çmimeve, deklarata mbi pershtatshmerine dhe deklarata nen betim.

Te gjitha keto jane te shenuara ne procesverbal nga takimi (bashkangjitur).

Autoriteti Kontraktues me kete veprim nuk ka respektuar Nenin 10 pika 1, pika 2 dhe pika 3 duke mos dorezuar te gjitha dokumentet e kerkuara.

Nuk eshte siguruar qasje per te gjitha dokumentet e dorezuara nga operatoret ekonomik!

Ne baze te kesaj ne konsiderojme qe oferta e OE-ve nuk ka qene e plote.

5/8

Nga Autoriteti Kontraktues na eshte thene qe nuk ka dokumente tjera, por pa na ofruar dokumentin "Lista e dokumenteve të tenderit mbështetëse" qe deshmon dokumentet e dorezuara nga OE, nder to do duhej te ishte edhe kerkesa per sekret afarist.

Vleresojme qe ofertat e dorezuara nga OE-te per te cilat kemi kerkuar qasje ne dokumente, duke mos dorezuar broshura fare dhe duke mos specifikuar as oferte teknike as brend te ofruar eshte e papergjegjshme dhe duhet te eleminohet.

Lidhur me mosdorezim te broshurave per produktet tanime kemi se paku dy vendime nga OSHP.

Vendimi nr: 214/22 dhe

Vendimi nr: 482/23

Autoriteti Kontraktues e zhvillon kete aktivitet te prokurimit ne kuader te kontrates kornize te AQP-se, prandaj baza eshte e qarte.

Ne vijim gjeni printscreen lidhur me specifikimin teknik nga kontrata ne mes te AQP-se

dhe OE.

Shenim: Te plotësohen me saketesi dhe qartësi kolonat në të djathtë " Specifikacioni teknik minimal i ofruar" dhe secila informat aty duhet të përputhet me katalogun të cilin e ofroni. Pra, gjithsecila informatë e plotësuar nga ju duhet të jetë edhe në katalog që të mund të vërtetohet gjatë vlerësimit. Ku kërkohet "minimumi" ose "or beter", ju duhet të shkruani sakt se çfarë ofertoni, ndërsa kur kërkesa është e prerë si p.sh "Mausi dhe tastieri: USB Mouse & OWERTY Keyboard", ju mund ta plotësoni me "✓ ose X".

- **Për secilin produkt duhet të specifikoni emrin e modelit që e ofertoni. Në kolonën e parë të secilit produkt tek – Prodhuesi – Brand Name, duhet të shkruani emrin e modelit duke përfshirë emrin e prodhuesit dhe emrin e saktë të modelit të cilin e ofroni;**
- **Tek laptop-ët duhet të ofroni çanta të cilat duhet të jenë të të njëjtit prodhues e përfshirë në konfiguracion;**
- **Sistemi operativ tek PC dhe Laptop duhet të jetë Windows 11 Pro 64 bit supported, ndërsa për licencën duhet të ceket në mini-tender pasi që nëse licencat sigurohen nga ASHI nuk duhet të kërkohen, por në rastet kur licencat nuk sigurohen nga ASHI, pajisjet duhet të kërkohen së bashku me licenca.**
- **Specifikat teknike të paraqitura në këtë marrëveshje kornizë janë specifikat minimale edhe për fazën e minitenderve ndërsa institucionet në fazën e dytë (atë të minitenderëve) kanë të drejt të avancojnë këto specifika teknike duke përfshirë edhe kërkesën p.sh "Vertical Tower jo flat. (MT) ose (DT) apo të kundërtën"**

Perfundim Citati

Ne në baze te atyre qe kemi cekur me lart, OE-te per te cilat kemi kerkuar qasje ne dokumente nuk kane dorezuar specifikim teknik ,broshura, brand, model te produkteve te kerkuara.

Prandaj mos dorezimi i specifikimit teknik pamundeson vleresimin e drejt per te gjithe OE-te.

Duke u bazuar ne te gjitha keto me lart, ne do te bashkangjesim vendimet e OSHP-se lidhur me mosdorezim te specifikimit teknik, procedure e zhvilluar ne kuader te AQP-se.

6/8

Pra, kemi te bejme perseri me te njejten kontrate kornize, e cila eshte vazhduar, prandaj konsiderojme qe eshte koncept i njejte.

Vendimet e OSHP-se jane pikerisht per nje kontrate e cila eshte zhvilluar dhe zhvillohet ne kuader te AQP-se.

Pasiqe lenda e Ankeses eshte e njejte, procedura e prokurimit eshte e njejte, zhvillohet ne kuader te kontrates kornize me AQP-ne, poashtu kemi vendime te OSHP-se (214/22, 482/23) prandaj kerkojme nga Organi juaj shqyrtues te merr vendim duke u bazuar ne

argumentet e lartecekura.

Autoriteti Kontraktues lidhur me kerkesen tone per Rishqyrtim eshte pergjigjur si ne vijim:

Bazuar në kërkesën tuaj lidhur me kataloge ne dosje te tenderit nuk është kekruar as katalogu as kriteret tjera katalogu ofrohet te AQP fillim te nenshkrimit te kontratave.
Qasje ju është lejuar sipas nenit 11 të LPP-ës, si informata sekrete afariste të cilat janë kërkuar nga OE, që të klasifikohen nga AK vetëm dokumentet qenuk jan sekret afarist.

Nga ajo qe eshte thene nga AK si pergjigje, ne nuk e kemi te qarte se per cilat sekrete afariste behet fjale, cilat jane dokumentet per te cilat eshte paraqitur kerkese per sekret afarist?!

Ndersa per pjesen e mos vendosjes se broshurave apo specifikimeve teknike te ofertuara (brand, model,…) ne kemi ofruar argumente te mjaftueshme si me lart, per me teper po

citojm edhe vendimin e panelit shqyrtues (Nr.482/23) per situate te njejte.

Citojme

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Paneli shqyrtues administroi me të gjitha shkresat e kësaj lënde, duke i analizuar të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e palëve të cilat (në përmbledhje) i shqyrtoi si në vijim:

Pohimet ankimore të OE ankues

Ankuesi (me të dhëna si më sipër) ka atakuar vendimin e cituar si më sipër të AK nga aspekti i pergjegjshmërisë së OE të rekomanduar për kontratë duke pretenduar se AK ka bërë shkelje të dispozitave ligjore, ngase kundërligjshëm ka shpall fitues një OE i cili nuk ka dërguar specifikim teknik të detajuar të pajisjeve të ofruara, ashtu sikurse kërkohet me LPP (Neni 28), RRUOPP, Pika 20 dhe Marrëveshjen Publike Kornizë si bazë e kësaj Ftese për Ofertim. Në Aneksi 1_Specifikimet Teknike të Detyrueshme, të kësaj Marrëveshje Publike Kornizë, saktësohet qartë se, cit: Për secilin produkt duhet të specifikoni emrin e modelit që ofertoni. Në kolonën e parë të secilit produkt tek Prodhuesi- Brand Name dhe në kolonën e fundit dueht të shkruani emrin e modelit duke përfshirë emrin e prodhuesit dhe emrin e saktë të modelit të cilin e ofroni. Lidhur me këtë eksperti shqyrtues ka konstatuar se AK ka bërë lëshime sepse tek dokumenti i specifikimeve teknike duhet të përfshije edhe informata për modelet dhe specifikimet e paisjeve të ofertuara dhe lëshim në FPO nga AK, është i pa-përmirësueshëm në këtë fazë andaj rekomandohet të anulohet komplet aktiviteti i prokurimit. Për panelin shqyrtues nuk paraget pasqyrim të gjendjes reale, ngase ne dokumentacionin e këtij aktiviteti rezulton se ne ofertën e OE përkatësisht Specifikimet teknike, ne asnjë vend nuk precizohet Prodhuesi se me çfarë pajisje oferton. Pra, duke ju referuar dokumentacionit te këtij aktivitetit të prokurimit rezulton se OE i shpallur fitues për këtë procedurë pikërisht tek specifikimet teknike te detyruara të ofruara në ofertën e tij nuk përcakton ne asnjë vend brendin apo prodhuesin e pajisjeve te cilat do ti liferoj apo me te cilët ka aplikuar. I vetmi dokument i cili është relevant për këtë aktivitet është deklarata e OE i cili thekson se të gjitha produktet janë sipas specifikimet te kërkuara mirëpo prap edhe ne deklaratën e tij nuk specifikohet brendi apo prodhuesi me te cilin oferton.

- Përfundim -

Paneli shqyrtues konsideron se një pjesë e pohimeve ankimore janë pjesërisht të bazuar, sikurse është shpjeguar dhe si më sipër, kurse AK nuk ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 59 dhe 60 të LPP. Kthimi i një aktiviteti të prokurimit në ri-vlerësim, me fakte dhe prova kontestuese dhe/ose me bazë ligjore, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitv të këtij vendimi.

Perfundim Citati

Siç theksohet edhe ne vendimin e OSHP-se (Nr:214/22 dhe 482/23) ne keto rast ankese kemi te bejme me OE i cili nuk ka vendosur specifikim teknik, model, brand, broshure per produkte.

Vlen te theksohet qe edhe OE Cacttus Sh.A. nuk ka vendosur vendosur specifikim teknik, model, brand, broshure per produkte per te cilat ka ofertuar.

Per korrektesi Oferta jone ne kete aktivitet Prokurimi eshte e kompletuar me broshura dhe specifikim teknik per te gjitha produktet e ofertuara.

BAZUAR NE TE DREJTEN JURIDIKE. VLERESOJME QE VENDIMET E MEHERSHME TE OSHP PER RASTE IDENTIKE DUHET TE SHERBEJNE SI BAZE APRIORI PER VENDIMET NE VAZHDIM.

Duke u bazuar ne argumentet me larte kerkojme nga Organi juaj shqyrtues qe te merr vendim si ne vijim:

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar Ankesa e OE "ARITECH SHPK" lidhur me tenderin "Marrëveshje kornizë – Furnizim me Pajisje të Teknologjisë Informative për USHAF)" me nr. prokurimi UA/2016-23-5755-1-1-1

ANULOHET Njoftimi mbi vendimin e AK-se nga "Marrëveshje kornizë – Furnizim me Pajisje të Teknologjisë Informative për USHAF)", tenderi të Rikthehet ne Rivleresim.

AK-së.

KRITERET PËR VLERËSIM

ANEKSI 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

1. Përshkruaj specifikimet teknike, në mënyrë jo diskriminuese, karakteristikat e detyrueshme te objektit te kontratës siç janë: Kualiteti, sigurimi i kualitetit, performanca, terminologjia, kërkesat e dizajnit, simbolet, dimensionet, testimi dhe metodat e testimit, sigurimi, paketimi, shënjimi, etiketimi.

Specifikimet teknike duhet të përpilohen në mënyrë që të përputhen me qëllimin e prokurimit dhe të ofrojnë qasje sa më të madhe te operatorët ekonomik të interesuar.

Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar te vendosë specifikim teknik qe favorizojnë ose dis-favorizojnë një ose me shume operatorë ekonomik.

[2. Nëse variantet lejohen Autoriteti Kontraktues duhet te ceke specifikimet minimale që duhet të përmbushen nga një variant dhe çdo kërkesë specifike për prezantimin e variantit të tillë janë]

Nr	Brand Name		Sasia
1	Brand Name All in One PC – Model VI		170 copë
	Prodhuesi:	Brand Name	
	Sistemi Operativ:	Windows 11 Pro 64 bit supported (pajisja duhet të vijë me licencë)	
	Procesori:	Min. Intel Core i7, min gjenerata e fundit në datën e publikimit të njoftimit	
	Memorje:	Min 32 GB DDR4	
	Disku:	Min. 1 TB SSD NVMe M.2	
	Kartela Grafike:	Minimum 4GB GDDR6	
	Screen Resolution:	Min 1920x1080, 16:9 aspect ratio, 1000:1 contrast ratio, anti glare	
	Monitor:	Min 26.5''	
	Porte shtesë:	Min. 1 x USB 3.2 Type C, 3x USB 3.2 Gen1, 1 HDMI-in or DP ose porte shtese me te mira	
	Networking:	Gigabit Ethernet, integratet Wi-Fi, bluetoth	
	Camera	Min 1080p, microfone etc	
	Tjera:	EU-US ENERGY STAR	
	Power:	EU Standard	
	Flex Stand:	Tilt	
	Keyboard & Touchpad:	USB Mouse & QWERTY Keyboard	
	Garancioni:	**3 vite**	
2	Brand Name Mobile Workstation –Model IV		17 copë
	Prodhuesi:	Brand Name	
	Sistemi Operativ:	Windows 11 Pro 64 bit supported (pajisja duhet te vije me licence)	
	Procesori:	Min. Intel Core i9, min gjenerata e parafundit në datën e publikimit të njoftimit	
	Memorje:	Min 1x64 GB DDR4 me mundësi shtimi te kapacitetit deri ne 128 GB	
	Disku:	Min. 2x1 TB SSD NVMe M.2	
	Kartela Grafike:	Min 8GB dedicated GDDR6	
	Monitor:	Min. 16''FHD	
	Bateria:	Battery Life 8+hour	
	Porte shtese:	Min. 2 x USB 3.0-3.2, 2x Type C, HDMI or Display Port	

B07 Ftese per ofertim -sipas kontrates publike korniz - mini tender 6 / 14

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

(VENDIMI MBI KERKESE PER RISHQYRTIM)

Ministria e Arsimin, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Inovacionit, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të parashtruar nga ARITECH, PRISHTINË - LIPJAN KM.10- PËRBALLË QMI- SË, 10500, GRACANICAtë datës 19.12.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit: Titulli: Marrëveshje kornizë – Furnizim me Pajisje të Teknologjisë Informative për USHAF, kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, nxjerrë këtë:

VENDIM

REFUZOHET si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruar nga ARITECH, PRISHTINË - LIPJAN KM.10- PËRBALLË QMI- SË, 10500, GRACANICA

Arsyetim

ARITECH, PRISHTINË - LIPJAN KM.10- PËRBALLË QMI- SË, 10500, GRACANICAsi palë e pa kënaqur ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim me datë 19.12.2023, kundër Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, lidhur me tenderin: Furnizim me pajisje dhe ngritjen e Infrastruktures se Qendrës për Qertifikimin e produkteve në USHAF, duke pretenduar se janë bërë shkelje të dispozitave të LPP-së, në:

Pretendimet Ankimore

ARITECH, PRISHTINË - LIPJAN KM.10- PËRBALLË QMI- SË, 10500, GRACANICA, pretendon se jan shkelur nenet 10,59

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet lidhur me pikat ankimore te OE:

Përgjigje lidhur me pretendimet ankimore;

Ne si Autoriteti Kontraktues,kemi shqyrtuar me kujdes të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara në kërkesë për rishqyrtim. Konsiderojmë se asnjë nga pretendimet ankimore nuk qendron

Bazuar në kërkesën tuaj lidhur me kataloge ne dosje te tenderit nuk është kekruar as katalogu as kriteret tjera katalogu ofrohet te AQP fillim te nenshkrimit te kontratave.
Qasje ju është lejuar sipas nenit 11 të LPP-ës, si informata sekrete afariste të cilat janë kërkuar nga OE, që të klasifikohen nga AK vetëm dokumentet qenuk jan sekret afarist.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të ushtroj ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHPS-së duhet të dorëzohet brenda (10) ditëve pas këtij vendimi

Vendimi dorëzohet:

1. Ix1 ARITECH, PRISHTINË - [illegible]

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **ARITECH**

Pretendimi nr.1

Pretendimet kryesor te OE ankues kanë sipas ankesës nr.22/23 janë kundrejt OE të rekomanduar për kontratë, ku sipas OE ankues OE I rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar fare specifikacionin Teknik, me emrin e prodhuesi dhe emrin e modelit me të cilin ka ofertuar, kërkesa këto të ftesës për ofertim si dhe kontratës kornizë të AQP-së me nr. UA/2016-23-5755-1-1-1.

Pas analizimit të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë, nuk kemi gjetur se I njëjti ka ofruar specifikacion Teknik , të dhënat e prodhuesit dhe modelit që ofertohet ashtu si është kërkuar në dosje të tenderit si dhe përmes dosjes së tenderit të kontratës kornizë të AQP-së me nr. UA/2016-23-5755-1-1-1.

Po ashtu vlerësojmë se është i bazuar pretendimi ankimor për qasje të kufizuar në dokumente, pasi nuk është dëshmuar se zbulimi i informatave (të kërkuara nga OE ankues) në ndonjë mënyrë e dëmton OE e rekomanduar për kontratë.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është I bazuar.

Pretendimi nr.2

OE ankues po ashtu pretendon se edhe OE:"Cacttus" vendosur vendosur specifikim teknik, model, brand, broshure për produkte për te cilat ka ofertuar.

Pas analizimit të ofertës së OE Cactuss, kemi gjetur se I njëjti ka ofruar specifikacionin Teknik me të gjitha të dhënat e nevojshme siç janë emri I prodhuesit, modeli saktë me të cilin oferton përshirë edhe specifikacionin Teknik të detajuar të modelit me të cilin oferton.

Provë: Oferta e OE Cactuss, Aneksi 1-specifikaiconi Teknik.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimet ankimore kundjret OE Cacttues janë të pabazuara.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **UNIVERSITETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA NË FERIZAJ**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **ARITECH**

Ilir Halili